

VENDIM
Nr.199, datë 26.12.2003

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK “RASH”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", rregullores "Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë" të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe të kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit në licencën nr.025/FML të subjektit radiofonik “RASH” të emrit të subjektit të licencuar, me vendimin nr.29, datë 30.10.2000 të KKRT-së nga shoqëria Edisud sh.a. në shoqëria Edisud Radio-TV sh.p.k.
2. Në mbarim të afatit të licencimit, sipas licencës nr.025/FML, të rinovojë për një afat të ri 3-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë subjektin “Edisud Radio-TV” sh.p.k., për radion “RASH”.
3. Kushtet e licencës, sipas pikës 2 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
4. Ky vendim hyn në fuqi në datën 3.1.2004 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sefedin Çela